



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

## BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT

JAVA 01 1 – 7 Janar 2018

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 rrethe ose 100% (=36/36) e tyre

3 rrethe ose 8% (=3/36) e tyre kanë raportuar me telefon, faks, postë:  
HAS, M. MADHE, PEQIN,

33 rrethe ose 92% (=33/36) e tyre kanë raportuar me postë elektronike:

BERAT, BULQIZË, DELVINË, DEVOLL, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, GRAMSH, KAVAJË, KOLONJË, KORÇË, KRUIË, KUÇOVË, KURBIN, LEZHË, LIBRAZHD, LUSHNJE, MALLAKASTËR, MAT, MIRDITË, PËRMET, POGRADEC, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, TROPOJË, VLOREË.

Pa raportim brenda afatit, asnjë rreth ose 0% (=0/36) e tyre:

### NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS “ALERT” NË JAVËN 01

	JAVA 01
<b>DIARRE PA GJAK</b>	<b>1.404</b>
<b>DIARRE ME GJAK</b>	<b>0</b>
<b>INF. RESP. TE SIPËRME</b>	<b>6.692</b>
<b>INF. RESP. TE POSHTËME</b>	<b>3.714</b>
<b>RASH ME TEMPERATURË</b>	<b>15</b>
<b>VERDHËZA</b>	<b>1</b>
<b>HEMORRAGJI ME TEMPERATURË</b>	<b>0</b>
<b>SUSPEKT MENINGITIS</b>	<b>0</b>
<b>ETHE TË PASHPJEGUESHME</b>	<b>0</b>
<b>Numri i Njësive Raportuese</b>	<b>388</b>
<b>% e Njësive Raportuese</b>	<b>91% (388/427)</b>

---

## Rash me temperaturë

7 raste janë raportuar nga rrethi i Fierit, 7 raste nga rrethi i Vlorës dhe 1 rast nga rrethi i Matit. Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe epidemiolog të rrethit 21 nga rastet nuk janë suspekt fruth apo rubeolë por varicelë.

---

## Suspekt Fruth

Nga rrethi i Tiranës janë raportuar disa raste të dyshuara për fruth, të cilat janë duke u hetuar.

---

### NË LIDHJE ME SURVEJANCËN E SINDROMIT “RASH ME TEMPERATURË” TËRHEQIM VËMENDJEN SI MË POSHTË:

1. Rritje të vëmendjes në lidhje me identifikimin dhe marrjen e mostrave për rastet rash me temperaturë.
2. Mundësi të lartë të importimit nga Maqedonia, Kosova, Greqia dhe Italia
3. Mundësi transmetimi indigjen në popullatën Rome që lëviz dhe kjo kërkon evidentim dhe vaksinim kudo që janë.
4. Mundësi transmetimi në popullatën e cila emigron dhe kthehet në vend sidomos në zona rurale dhe familje të varfëra ku shpesh emigrimi është jo i ligjshëm
5. Mundësi transmetimi spitalor kur rastet nuk izoloohen dhe kjo të theksohet për të gjitha spitalet ku rastet duhet të izoloohen dhe të përdoren mjetet e mbrojtjes personale për transmetimin ajror.
6. Po ashtu vihet re që ka hezitime në persona intelektualë apo ka përhapje të thashethemeve që vaksina që përdoret në institucionet shtetërore nuk është e mirë shpesh për përfitime personale nga personel shëndetësor. Hezitimet mund të kapërcehen vetëm falë punës së personelit shëndetësor.
7. Vëmendje në lidhje me evidentimin e popullatës që nuk është e vaksinuar dhe evidentimi i grupeve të caktuara që refuzojnë vaksinimin, hezitojnë në lidhje me të, nuk e kërkojnë atë apo kanë mbetur të pavaksinuar.
8. Evidentimi i të pavaksinuarve jo vetëm për secilin rreth dhe brenda rrethit për secilin komunitet përfshirë këtu dhe personelin shëndetësor, lagje apo fshat.

---


## Verdhëza

Rasti është i grupmoshës 45-59 vjeç dhe është raportuar nga rrethi i Elbasanit. Më pas diagnoza rezultoi “Hepatit viral C”


---

### Infeksione Respiratore

*Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve*




*Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave*




Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqet ritje në javën 01 te vitit 2018 krahasuar me javën paraardhëse, java 52/2017.

### Diarre pa gjak

*Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve*




*Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave*




Trendi në kohë i “Diarre pa gjak” paraqitet ritje në javën në javën 01 të vitit 2018 krahasuar me javën paraardhëse, java 52/2017.

**Trendi i “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 40 – 01 të sezonit 2016-2017 dhe të sezonit 2017-2018. Numri i rasteve.**




Në javën e 01 të vitit 2018 vërehet një trend në ritje i numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme dhe ky numër është më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ku trendi kishte kaluar pragun epidemik.

**Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas grupmoshës në javën e 01 të vitit 2018. Numri i rasteve dhe Incidenca (raste/10.000)**




### Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000



### Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas rretheve në javën 52 të vitit 2017 dhe 01 të vitit 2018. Incidenca (raste/10.000)




### Trendi i “Diarreve pa Gjak” në javët 40 – 01 të sezonit 2016-2017 dhe të sezonit 2017-2018. Numri i rasteve.



Në javën e 01 të vitit 2018 vërehet një trend në ritje i numrit të rasteve të “Diarreve pa gjak” dhe ky numër është 17% më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

### Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas rretheve në javën 52 të vitit 2017 dhe javën 01 të vitit 2018. Incidenca (raste/10.000)



Nga komunikimi me rrethet, shumica e rasteve janë raportuar nga Urgjenca e Spitaleve dhe janë të shpërndara, pa grumbullime dhe lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre.

## Nivelet e Raportimit për javën e 01 sipas rretheve, në përqindje.

